

U-21/ Shqiperi - Bosnia 0-1

nga AlbaniaSoccer
E martë, 15 Tetor 2013 17:15



Ne Stadiumin 'Ruzhdi Bizhuta' te Elbasanit Kombetarja U 21, eshte mundur ne takimin e saj me Bosnje Hercegovinen me rezultatin 1 me 0, ku u perballen per kualifikimet e Kampionatit European te vitit 2015. Dy skuadra me jo shume potencial krahasuar me skuadrat e tjera te grupit ne te cilin luajne, ne fushen e blerte zhvilluan nje ndeshje jo shume te forte. Pjesa e pare ishte e karakterizuar nga nota monotone ndersa pjesa e dyte dhe pse disa here kuqezinjte tentuan ti afrohen portes nuk dha rezultat. Nje penalti e dhene per Bosnje Hercegovinen ne mitunten e 37-te e ekzekutuar nga Kveshic , ka vulosur dhe rezultatin e ketij takimi duke e lene kombetaren Shqiptare ne kuoten e 0 pikeve , ndersa Bosnje Hecrgovinen ne ate te 6 pikeve.